



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.07.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nën për nen i projektligjit “Për rininë”.

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla, Ardiana Jaku, Florenc Spaho, Majlinda Halilaj, Eugen Bojaxhiu, Koçi Tahiri, Amra Barova, Ervis Meço, Edmond Stojku dhe Halil Jakimi.

Mungojnë:

Klotilda Bushka.

Të ftuar:

Zamira Gjini – Drejtore e Përgjithshëm i Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Erzen Tola – Drejtor i Programimit Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator

Florian Nurçe – përgjegjës i Sektorit të Buxhetit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar

Irsa Ruçi – Drejtore e Shërbimit Kombëtar për Rininë

Matilda Bulku – specialiste në Sektorin e Politikave dhe Strategjive të Kërkimit Shkencor në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e komisionit me këtë rend dite: shqyrtimi i ligjit për rininë, për të cilin jemi komision për dhënie mendimi.

Të pranishëm kemi zotin Erzen Tola, drejtor i Programit të Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrin Rregullator, Irsa Ruçi, drejtore e Shërbimit Kombëtar për Rininë, Matilda Bulku specialiste në sektorin e Politikave dhe Strategjive të Kërkimit Shkencor.

Kalojmë në miratimin nen për nen të projektligjit.

Në nenin 1 përcaktimi: “ky ligj ka për qëllim” zëvendësohet me “qëllimi i këtij ligji është”. Miratohet.

Në nenin 2 termi “dialog i strukturuar” sugjeroj të hiqet pasi nuk përmendet më në projektligj.

Erzen Tole - Te ky propozim ne hezitojmë të përgjigjemi, sepse me të vërtetë në këtë projektligj nuk ka më një rregullim të posaçëm të dialogut të strukturuar, por në veprimtarinë e përditshme rinore dhe të strukturave dialogu i strukturave është një dialog që njihet dhe duhet të respektohet, kështu që si përkufizim mbetet në ligj.

Enver Roshi - Unë e di që në metodologjinë e ligjit kur jepen definicionet, janë në përputhje me përmbajtjen e ligjit dhe dialogu i strukturuar nuk përmendet në asnjë nen të ligjit. Kështu që unë e hedh në votim këtë.

Erzen Tole - Është i nevojshëm pastaj për aktet e tjera nënligjore.

Klodiana Spahiu - Nga përfaqësuesit e ministrisë, a mundet të kemi një sqarim? Mbase këtë përkufizim e keni edhe nga konsultat që kemi bërë në seanca dëgjimore me grupet e interesit ku përmendet “dialog i strukturuar”. Ju një pjesë të gjërave do ta sqaroni me VKM, por, ju lutem, të na jepni një sqarim pak më të hollësishëm. Është e vërtetë kjo që thotë kryetari kur një përkufizim nuk përmendet në ligj, nuk ka pse të lihet.

Erzen Tole - Është e vërtetë që përkufizimi “dialog i strukturuar” ka ardhur si pasojë e kërkesave të kahershme të organizatave joqeveritare. Në ligj nuk ka një rregullim konkret, por do të jetë i nevojshëm për aktet nënligjore, të cilat ne jemi duke i draftuar.

Nga ana e ministrisë jemi shprehur dakord me këtë propozim, edhe pse në diskutimin në parim e qartësuam që standardet u referohen hapësirave si shkollat, stadiumet e të tjera, megjithatë, duke qenë se ishte një kërkesë e komisionit, për ta qartësuar më shumë këtë definicion, jemi dakord që të shtohet ky përcaktim.

Enver Roshi - Atëherë, aprovet ndryshimi i propozuar nga komisioni. Germa “dh” të riformulohet me këtë përmbajtje: “Çdo punonjës i punësuar në sektorin publik ose privat, që punon me rininë, sipas parashikimeve të këtij ligji”

Erzen Tole - Lidhur me këtë propozim, ne nuk jemi shprehur dakord, sepse, po ta shikojmë në kontekstin ku është përcaktimi i punonjësit rinor, aty është përkufizimi se çfarë është punonjësi rinor dhe jo ku është punësuar. Për këtë nuk jemi dakord që të ndryshojë.

Edlira Bode – Ju thonë që punonjës rinor është personi i përgatitur që ka kryer trajnime të veçanta, edhe pse mund të jetë një i papunë për momentin.

Erzen Tole – Është përkufizim për cilësinë e personit, Është i trajnuar, mund të jetë i papunë, por e ka të fituar statusin e punonjësit rinor.

Enver Roshi – Sipas mendimit tim, çdo person që është i punësuar dhe merret me rininë e presupozon edukimin e vet.

Çfarë trajnimesh të veçanta ose eksperiencë duhet të ketë ky person për të punuar? Ligji më poshtë e shtjellon këtë, por unë mendoj se çdo person që merret i punësuar në sektorin publik ose privat që punon me rininë duhet të ketë edukimin sipas parashikimeve të këtij ligji.

Unë mendoj se propozimi ynë është më i mirë.

Erzen Tole - “Punonjës rinor” në këndvështrimin e hartuesit të ligjit konsiderohen të gjithë personat që kanë eksperiencë, janë të trajnuar për të qenë të tillë, që nuk lidhet domosdoshmërisht me punësimin dhe me vendin e punës. Pra, nëse themi që një person është i kualifikuar për të qenë punonjës rinor duhet të ketë këto cilësi që ne i kemi propozuar. Ndërsa një punonjës rinor që vetëm është punësuar atje dhe nuk i ka këto cilësi, nuk mund të jetë punonjës rinor.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka shumë organizata, të cilat ushtrojnë veprimtari në fushën e rinisë dhe mund ta fitojnë statusin vetëm për këtë shkak, por nuk është se kanë trajnimet e nevojshme për të qenë punonjës rinor.

Erzen Tole - Duke qenë se është ligj për rininë, ky lloj përkufizimi është i saktë për arsye se si punonjës rinor nuk merret vetëm ai që është i punësuar, por edhe çdo aktivist i mirë që punon me një grup të caktuar organizatë rinore të caktuar sipas interesave dhe grup interesave. Po vendosëm se do të jetë i punësuar, nuk duhet quajtur punonjës rinor.

I punësuar do të thotë që ka eksperiencë, që është marrë me rininë.

Roland Xhelilaj - Shpjegimi, që është këtu, sipas mendimit tim, është i saktë. Punonjësi rinor është çdo person që ka një trajtim specifik, ka edhe dëshirën. Ky është varianti i ministrisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erzen Tole - Në nenin 14 ka një përcaktim që lidhet me punësimin dhe ku është propozuar zëvendësimi i këtij përcaktimi me përkufizimin.

Neni 14 e ka të lidhur pastaj me pozicionin e punës, e ka në kuadër të punës rinore dhe jo në kuadër të statusit të punonjësit rinor.

Enver Roshi - Atëherë, miratohet.

Neni 3. Nuk ka sugjerime.

Miratohet.

Neni 4.

Miratohet.

Ilir Pendavinji – Duhet parë edhe mënyra e të shkruarit, sepse thoni “miratohen standardet”, nuk është “standardet”, është “standarde”.

Më falni!

Burrë 1-Ne shprehemi dakord, sepse është një lloj unifikimi i terminologjisë së ligjit.

Enver Roshi - Në germën “a” të nenit 6 bëhen këto ndryshime: hiqet përcaktimi “marrjen e mendimit të të rinjve” dhe zëvendësohet me përcaktimin “përfshirjen dhe pjesëmarrjen e të rinjve dhe organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë”.

Unë jam dakord për këtë, sepse jo vetëm mendimi por edhe pjesëmarrja e tyre është me vlerë për ligjin për rininë.

Erzen Tola - Edhe ne shprehemi dakord, por me një ndryshim, pra nuk mund të përfshijmë vetëm organizatat rinore që të japin mendim, por duhet të përfshijmë të gjithë organizmat e rrjetit rinor. Ky është propozimi ynë, e njëjta pikë por pika e propozuar nga ana jonë, pra të mbetet pjesa e marrjes së mendimit nga i gjithë rrjeti rinor, jo vetëm nga organizata.

Enver Roshi – Atëherë neni 6, me propozimet e komisionit miratohet.

Kalojmë te neni 7, pas germës “f”, të shtohet germa “g” me përmbajtje si më poshtë: “Caktimin e të paktën një personi përgjegjës në bashki për çështjen e të rinjve”. Ky është propozim i komisionit.

Pra, ne mendojmë që një person i fokusuar në nivel bashkie duhet të jetë.

Erzen Tola – Atëherë, në lidhje me çështjen, zoti kryetar, ne mendojmë se nuk duhet të thellohem më tej me përcaktime të tilla, sepse mund të vijmë në kundërshtim me ligjin vetëqeverisjes vendore dhe mund të cenojmë autonominë vendore, strukturat në njësitë vendore përcaktohen me vendim të këshillit bashkiak.

Në nenin 7 kemi parashikuar përcaktimin e strukturave përgjegjëse për rininë. Kaq është e mjaftueshme besoj. Kjo detyron të gjitha bashkitë të parashikojnë në organigramën e tyre personat përgjegjës për rininë.

Këtu nuk është strukturë, por është një person përgjegjës që merret me rininë.

Ligji kërkon diçka më shumë një strukturë një drejtori të përgjithshme, një sektor në varësi të madhësisë së njësisë së qeverisjes vendore, ose sasisë së të rinjve që kanë në administrim.

Enver Roshi – Kush është dakord me propozimin e komisionit?

Rolan Xhelili – Mund të bjerë ndesh me projektligjin e qeverisjes vendore, por në të gjitha bashkitë është drejtorja e arsimit dhe personi aty është. Pse e vendosim në ligj? Të merret një person me rininë çfarë ndryshon?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erzen Tola - Opinioni im në mbështetje të kryetarit është që i japim pak më shumë rinisë se i është dhënë deri sot. E vendosim edhe te ligji detyrimin që ka pushteti vendor që të ketë një person që të merret me rininë.

Në nenin 7 germa “e” është parashikuar “krijimin e strukturave administrative për çështjet e rinisë”.

Klodiana Spahiu - Ky propozim që bëtë ju, zoti kryetar, do të kishte shumë vlerë nëse ne do të kishim një koordinator kombëtar për rininë dhe në çdo rajon do të kishte koordinatori rajonal që do të ishte i vlefshëm, sepse koordinatori kombëtar duhet të ishte i lidhur me të gjithë koordinatorët rajonalë të këtij koordinatori kombëtar në varësi të ministrisë. Ky nuk do të kishte më lidhje me strukturën e bashkisë, por do të ishte koordinator rajonal. Kështu e mendoj unë. Tani, në qoftë se struktura është në bashki, do të na e rrezojnë, se nuk shkon... Po të ishte...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Adelina Rista - Në bazë të ligjit, institucioni përgjegjës ngrihet pranë ministrisë. Institucioni përgjegjës është person juridik, publik, buxhetor, për rininë, që varet direkt nga ministri përgjegjës.

Tani, në njësitë e qeverisjes vendore kjo strukturë zbret vertikalisht. Njësitë e qeverisjes vendore, çdo fund viti, në dhjetor, me vendim të këshillit bashkiak, miratojnë strukturën, drejtoritë përkatëse për vitin pasardhës, në bazë të ligjit për pushtetin vendor. Ky ligj e detyron njësinë e qeverisjes vendore të ngrejë strukturën përkatëse në bazë të institucionit përgjegjës në ministri, pra edhe njësia e qeverisjes vendore do të ngrejë strukturën përkatëse.

Se sa persona do të ketë, kjo është në varësi të bashkisë, në bazë të numrit të të rinjve apo të organizatave që ka. Në bazë të kapaciteteve që ka, bashkia e vendos zyrës e saj me 4, 5 apo 7 vetë. Kjo varet nga kapacitetet e bashkisë, ama ligji e detyron bashkinë të ngrejë strukturën, jo një person. Pra, është drejtori më vete.

Faleminderit!

Enver Roshi – Bazuar në eksperiencën dhe buxhetet e bashkive, që, në fund të vitit dhe në fillim të vitit tjetër janë shumë të azhurnuara me buxhetet e tjera, për shumë bashki do të mbetet luks caktimi i një personi për rininë, ndërsa kur e caktojmë ne, atëherë ai thotë se e ka me ligj për ta bërë këtë.

Adelina Rista - Vetë kryetari i bashkisë ka kompetencën të zgjedhë anëtarët e këshillit vendor të rinisë, me 4 vetë. Ky këshill është këshillimor, pranë kryetarit të bashkisë, ndërsa struktura, drejtoria përkatëse, që merret me rininë, është tjetër gjë. Sot ka nga një person që merret me grupe të ndryshme të interesit, sipas komuniteteve e të tjera. Kjo është drejtori më vete. Nëse themi “një person”, e kalon kryetari me atë “një person”... Jo, në strukturë duhet të miratojë drejtorinë.

Enver Roshi - ...pro propozimit të komisionit, pra për caktimin e një personi...?

Sa janë pro propozimit të Ministrisë së Arsimit?

Atëherë, varianti i qeverisë...

(Mungesë regjistrimi)

Kalojmë te neni 8.

E hedhim në votim.

Miratohet. Nuk ka sugjerime.

Neni 9.

E hedhim në votim.

Miratohet.

Në fjalinë e dytë të pikës 2 të nenit 10, hiqet përcaktimi “për Këshillin Kombëtar të Rinisë”.

Erzen Tola – Nuk e kuptoj propozimin që ka bërë komisioni, zoti kryetar.

Këtu ka pasur një lloj mosbashkërendimi të saktë të termave, pika e parë me pikën e dytë. Ne kemi propozuar të unifikohej termat. Pra, në qoftë se te neni 9 për Këshillin Kombëtar të Rinisë thuhet se caktimi i anëtarëve, mënyra e organizmit dhe funksionimit, bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, edhe këtu duhet unifikuar e njëjta terminologji, pra “miratuar me vendim të Këshillit të ministrave për përcaktimin e anëtarëve dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Rinisë”, pra duhet bërë vetëm një unifikim, jo ndryshim.

Enver Roshi – ...këshilli i bashkisë, nëpërmjet VKM-së, cakton zgjedhjen e anëtarëve të pushtetit vendor.

Erzen Tola – Jo, nuk u ndërhyhet njësisë vendore. Edhe këtu është respektuar autonomia. Këtu thuhet se këshilli vendor ngrihet me vendim të këshillit bashkiak. Për analogji, ato mund të marrin kriteret dhe procedurat që ka përcaktuar Këshilli i Ministrave, por kjo nuk është detyruese. Ato mund të përcaktojnë edhe kriteret e tjera.

Enver Roshi – ...të mos ketë kriteret dhe procedura.

Erzen Tola – Edhe kështu mund të jetë. Jam dakord t’i heqim kriteret dhe procedurat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi – Po, Ilir.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Roland Xhelilaj – Kam një pyetje, më shumë për merak.

Këshilli Kombëtar i Rinisë kryesohet nga ministri përgjegjës. Pse të mos kryesohet nga zëvendësministri, që mbulon rininë? S’e lejon...?

Erzen Tola – Bazuar në ligjin nr. 90, ”Për organizmin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, titullarët e institucioneve janë ata që përfaqësojnë institucionet, pastaj delegohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi ... 11. Për teknikë legislative, sugjeroj që pika 4 të jetë pika 5 dhe pika 5 të jetë pika 4. Besoj se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

10-a u miratua, pra hiqet...

Miratohet neni 10.

Kalojmë te neni 11.

Për teknikë legjislativë, sugjeroj që pika 4 të jetë pika 5 dhe pika 5 të jetë pika 4. Besoj se nuk ka ndonjë rëndësi për ju.

Ministria?

Erzen Tola – Nuk e kuptoj nevojën e ndryshimit të pikave, sepse edhe në këtë formë, siç është propozuar, besoj se është mirë dhe funksionale. Para se organizatat të financohen, ato duhet të regjistrohen dhe, në logjikën e renditjes hierarkike të veprimeve, regjistrimi është para financimit. Nuk e kuptoj nevojën dhe argumentin e zëvendësimit të pikave.

Enver Roshi -...me propozimin e Ministrisë së Arsimit, të qeverisë.

Kush është dakord me propozimin e Ministrisë së Arsimit?

Vetëm ndërrohen vendet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta hedhim në votim. Tjetër gjë është regjistrimi, tjetër është... Si logjikë, regjistrimi është i fundit.

Dakord, aprovohet mendimi i ministrisë.

Neni 12. Nuk kemi zgjerim këtu.

E hedhim në votim.

Miratohet.

Neni 13.

E hedhim në votim.

Miratohet.

Neni 14.

E hedhim në votim.

Nuk ka ndryshim, bie poshtë...

Miratohet.

Neni 15.

Miratohet.

(Nga neni 16 deri te neni 20 u ndoq e njëjta procedurë votimi.)

Mendimet e Komisionit të Shëndetësisë për ligjin “Për rininë” u dhanë dhe do t’i jepen komisionit përgjegjës, medias, arsimit...

Enver Roshi – Faleminderit!

E mbyllim këtu.

Suksese!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.07.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me grupet e interesit për projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit".

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla, Ardiana Jaku, Florenc Spaho, Majlinda Halilaj, Eugen Bojaxhiu, Koçi Tahiri, Amra Barova, Ervis Meço, Edmond Stojku dhe Halil Jakimi.

Mungojnë:

Klotilda Bushka.

Të ftuar:

Raúl González - Shefi i zyrës së OBSH-së Tiranë

Artan Mesi – përfaqësues i zyrës së Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Tiranë

Migena Kondo – përkthyes

Lorent Gordi - përfaqësues i Philip Morris International

Përparim Tushaj - konsulent për industrinë e Duhan Cigareve (Përfaqësues i JTI)

Plarent Kristo - menaxher i Përgjithshëm i IDS-ë (distribucion i produkteve të duhanit)

Fatmir Kazazi - konsulent i pavarur

Klodian Cici - përfaqësues i BAT-së

Mira Rakacolli – Zëvendesministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Antoneta Njehrrëna - drejtor Juridik në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Vjollca Braho - kryeinspektor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Orjola Shahaj - këshilltare në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

HAPET MBLEDHJA

Enveri Roshi – Mirëmëngjesi!

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë zhvillon mbledhjen me këtë rendite:

Seancë dëgjimore me grupet e interesit për projektligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, "Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit".

Të ftuar kemi përfaqësues nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, doktor Raúl González, i cili është shefi i zyrës së OBSH-së në Tiranë, zotin Artan Mesi, i cili punon pranë zyrës së OBSH-së në Tiranë, zonjën Miken Kondo, përkthyes, zotin Lorent Gordi, përfaqësues i *Philip Morris International*, zotin Përparim Tushaj, konsulent për industrinë e duhan-cigareve, përfaqësues i ETI-së, Tiranë dhe zotin Fatmir Kazazi, konsulent i pavarur. Kurse nga Ministria e Shëndetësisë, që është hartuese e ligjit, marrin pjesë zëvendësministria Mira Kacolli, zonja Antoneta Njehrrëna, drejtoreshë juridike, zonja Vjollca Braho, kryeinspektore dhe zonja Orela Shahja, këshilltare.

Unë dua ta hap takimin duke dëgjuar udhëzimet e përfaqësuesit të zyrës së OBSH-së në Tiranë, doktor Raúl González.

Raúl González – Shumë faleminderit që mundësuat praninë time këtu!

I nderuar zoti kryetar,

E nderuar zonja Zëvendësministre,

Gjithashtu, përshëndetja ime shkon edhe për ministrin,

Dua të theksoj që çështja e shëndetit nuk i përket vetëm Ministrisë së Shëndetësisë. Ndjej keqardhje që nuk mund të flas asnjë fjalë në gjuhën shqipe, pasi kam vetëm dy muaj në Shqipëri, por shpresoj shumë që në të ardhmen të filloj të mësoj disa fjalë!

Dua të ritheksoj se ky është një ligj shumë i rëndësishëm dhe shkon përtej kompetencës së Ministrisë së Shëndetësisë, pasi përfshin politikëbërësit dhe ligjbërësit, të cilët kanë një rol shumë të rëndësishëm në këtë proces, që ka të bëjë me shëndetin e qytetarëve.

Në radhë të parë ky ligj është një kuadër për ushtrimin e kompetencave nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

Në radhë të dytë, në këto lloj procesesh, që kanë të bëjnë me këtë lloj fushe, pyetja e parë në aspektin e shëndetit publik është: a kemi një problem dhe si do ta trajtojmë? A është duhani një

problem në Shqipëri? Për t'i dhënë një përgjigje duhet të dimë se cili është efekti që jep ai, sa konsumohet nga popullata, pra sa duhanpirëse është dhe cili është ndikimi që jep.

Ne e dimë që në Shqipëri ka shumë persona që e pijnë dhe pasojat e pirjes së duhanit janë të mirëpërcaktuara, të mirëvendosura dhe të mirëprovuara, ato janë pasoja që sjellin sëmundshmëri, paaftësi dhe, së fundmi, kosto financiare.

Pasi konkludua dhe ramë dakord që ky është një problem në Shqipëri, atëherë cilat janë mekanizmat apo instrumentet për ta adresuar. Në radhë të parë, Shqipëria e ka nënshkruar dhe ratifikuar konventën kuadër “Për kontrollin e duhanit”, e cila është një konventë detyruese, jo thjesht orientuese, dhe parashikon masa specifike. Pastaj janë aftësitë dhe kapaciteti i ligjbërësve shqiptarë, që të gjitha masat e parashikuara nga ligji kombëtar, të jenë në përputhje me konventën kuadër “Për kontrollin e duhanit”.

Jemi shumë të nderuar që Komisioni e Shëndetësisë i Kuvendit të Shqipërisë na ka dhënë mundësinë të bëjmë komente dhe të japim opinionin tonë për këtë ligj. Ne e kemi bërë analizën tonë dhe unë dua që të fokusohem në dy aspekte kryesore, si dhe dua që ligjbërësit shqiptarë t'i kenë parasysh ato. Aspekti i parë është toksiciteti i drejtpërdrejtë i duhanpirjes, pasojat, që i dimë, dhe aspekti i dytë, varësia që krijohet nga pirja e duhanit.

Varësia është një aspekt shumë i rëndësishëm i duhanpirjes dhe nëse shohim pas në kohë, kur nuk i kishim rregullat kaq të detajuara, për shembull, në vitet '50, ka qenë një kompani e mirënjohur dhe shumë e fuqishme e prodhimit të duhanit, e cila në mënyrë kriminale, shtonte substanca varësie në produktin e duhanit. Tani është pak më ndryshe, sepse ata i hedhin disa shije shtesë duhanit.

Dua të jap një shembull nga ligji, që po diskutojmë: nëse duam të përkufizojmë se çfarë është shija, pra “*flavor*”, duhet të kemi parasysh se shqisat tona dallojnë 4 shije kryesore: të thartën, të ëmblën, të kripurën dhe të hidhurën, por në ligj duhet të jemi akoma më të detajuar, duke mos e specifikuar shijen vetëm si shije, por duke i shtuar edhe elementin e erës. Kemi vënë re që edhe përkufizimet kanë ndryshuar nga njëri draft në tjetrin, si dhe kemi konstatuar se këto përkufizime janë thjeshtëzuar. A duhet realisht ta bëjmë këtë gjë? Ne duhet të jemi sa më të detajuar dhe të përkufizojmë të gjitha llojet e përdorimit të duhanit, sepse djalli është te detajet. Nëse marrim aspektin e kontrollit të publicitetit të duhanit, Shqipëria ka bërë një progres shumë të madh, por dua t'ju paralajmëroj që, nëse niseni për të bërë pazaret tuaja të fundjavës në tri apo katër supermarkata në Tiranë dhe shkoni të kasa për të bërë pagesën, jam i sigurt se do t'i konstatoni me

sytë tuaj paketat e cigareve. Prandaj ligji duhet të fokusohet në detaje, që të kontrollojë çdo mundësi që shfrytëzojnë kompanitë për të promovuar produktet e duhanit. Fëmija juaj mund të shkojë për të blerë diçka dhe do të ekspozohet vizualisht ndaj promovimit të këtyre produkteve.

Do t'i mbyll këtu komentet e mia të përgjithshme, por një i koment i fundit që kam është se detyra juaj kryesore si ligjbërës është që të merrni çdo masë për të mbrojtur shëndetin e qytetarëve. Nëse keni ndonjë pyetje, jam i gatshëm t'i përgjigjem.

Enver Roshi – Faleminderit, doktor Gonzales!

E gjej me vend t'ju falënderoj për sugjerimet tuaja shumë të dobishme për përmirësimin e ligjit të duhanit në vendin tonë. Ministria e Shëndetësisë ka bërë ndryshimet e veta dhe jam dakord me ju që detajimi duhet të jetë më i hollësishëm për të gjitha definicionet e dhëna në ligj. Sipas komunikimit që kemi bërë dhe sugjerimet tuaj bashkë me Ministrinë e Shëndetësisë, çdo gjë do të pasqyrohet në ndryshimet në ligj. Si profesionist i shëndetit publik, si komision dhe si parlament do të përdorim të gjitha mundësitë tona të ligjbërjes, që ky ligj të jetë sa më adekuat dhe konform udhëzimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, por edhe të rrugëve që çojnë në integrimin europian të Shqipërisë. Tashmë Shqipëria e ka nënshkruar konventën e ndalimit të duhanit, por mbetet shumë punë për të bërë. Prevalenca e duhanpirjes në meshkuj në Shqipëri është akoma e lartë, kujtojmë që 30% e vdekjeve në Shqipëri shkaktohet vetëm nga duhanpirja. E thamë edhe në mbledhjen e parë që për kancerin pulmonar mbi 90% është shkaktare duhanpirja. Nuk ka vetëm duhanpirje pasive, por edhe një element tjetër i duhanpirjes: orenditë e shtëpisë ku pihet duhan janë toksike dhe ndikojnë në gjendjen shëndetësore të familjes, në organet e tyre të frymëmarrjes, si dhe të popullatës në përgjithësi. Ju kujtoj që vetëm duhani ka mbi 4 mijë substanca toksike, veç atyre kancerogjene, si nikotina.

Fjala është për Ministrinë e Shëndetësisë.

A ka ndonjë koment nga ministria. Nuk ka.

Vazhdojmë me zotin Lorent Gordi, përfaqësues i Philip Morris International.

Fjala për ju, zotëri.

Lorent Gordi - Zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë,

Ju falënderoj për mundësinë që na jepni për të debatuar dhe diskutuar për këtë ligj!

Dëshiroj të falënderoj Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, të cilat kanë qenë të hapura gjatë formulimit të këtij ligji dhe ne kemi shprehur pa druajtje shqetësimet për industrinë e duhanit sot!

Do të doja të filloja me dy pyetjet që zoti Gonzales përmendi shumë hapur dhe me elokuencë. A kemi ndonjë problem kur bëjmë pyetje rreth shëndetit publik? Sa i madh është ky problem?

Gjithashtu, dëshiroj të shtoj edhe një pyetje të tretë: si po progresojmë në këtë drejtim? Ku jemi sot?

Unë punoj për më shumë se 15 vjet në role të ndryshme në këtë industri dhe e di shumë mirë që ky ligj, kur u formulua dhe u zbatua në vitin 2007, ishte në përputhje të plotë me EFSTS-në, dhe jo vetëm kaq, por u morën certifikata të niveleve shumë të larta si ligji më i mirë i asaj kohe, madje ishte më progresist se ligjet e tjera, të cilat që Europa nuk i kishte vënë në zbatim dhe as në implementim.

Si po progresojmë? Dua t'i kthehem kësaj pyetjeje. Nuk po u referohem shifrave të mia, por, sipas Organizatës Botërore të Shëndetit sot kemi rreth 700 mijë shqiptarë duhanpirës. Siç e tha edhe zoti Gonzales, ky është një problem, sepse ka të bëjë me varësinë. Nuk është e lehtë të lihet duhani. Kemi 790 mijë njerëz, që janë pjesë përbërëse e shoqërisë, të cilët, pa dyshim, kanë edhe kostot financiare dhe problematikën që i shoqëron.

Po ashtu, kemi një problematikë edhe për strukturën e shitjes së tyre. Sot 40% e produkteve të tregtuara shiten dhe prodhohen në mënyrë të paligjshme dhe në nivele shqetësuese; kjo duhet marrë në konsideratë. Sugjeroj që Shqipëria të bëhet pjesë e Organizatës Botërore të Shëndetit dhe e Konventës për tregtinë e paligjshme, ku të adresohet ky shqetësim, sepse jo vetëm industria, por edhe shëndeti publik janë në rrezik. Të gjithë biem dakord me ato që përmendi doktor Gonzales dhe nuk dua të shtoj asgjë, sepse edhe të pranishmit e dinë që ky produkt është i dëmshëm, por a janë produktet joligjore më pak të dëmshme apo më shumë të dëmshme? A duhet t'i adresojmë këto produkte? Në ç'mënyrë duhet t'i ndalojmë? Ligji aktual parashikon hapur në nenet e tij se cigaret e hapura me fije nuk duhet të tregtohen dhe ky ligj duhet të zbatohet në të gjitha nenet e tij.

Mendoj se ligji aktual është mjaft i mirë dhe i përsëndetur nga shumë instanca ndërkombëtare, por edhe në vend. Në draftimin e këtij ligji kanë marrë pjesë edhe mjekë, ndaj mendoj se në këtë rast ne nuk kemi objektiva të ndryshme me zotin Gonzales dhe as me OBSH-në në përgjithësi. Ne e kemi pranuar se duhani është i dëmshëm, por prej 10 vjetësh industria ka

filluar të bëjë investime të rëndësishme për produkte të reja, të cilat e ulin në 95% rrezikshmërinë e toksicitetit. Pra, toksinat e gjetura në cigaret me djegie, e theksoj, sot janë ulur në 95% në produktet e gjeneratës së re. Specifikisht dua t'u referohem cigareve elektronike dhe atyre me ngrohje, zhvillimi i të cilave besoj se do të vazhdojë më tej. E kuptoj skepticizmin e doktorëve dhe njerëzve që janë në dijeni të problemeve të shëndetit publik, por këtyre 790 mijë njerëzve u duhet dhënë mundësia e përdorimit të këtyre produkteve më pak të dëmshme, por jo të shëndetshme: a është rasti t'i marrim sot në konsideratë këta njerëz, të cilët vdekshmërinë, siç e përmendët ju, zoti kryetar, e kanë të lartë? A mund të trajtohet ky grup njerëzish me më shumë dinjitet dhe t'u japim mundësi të përdorin një produkt më pak të dëmshëm dhe në një moment tjetër të shpresojmë për ta lënë atë produkt? Nuk është vetëm shpresë. Shëndeti Publik Anglez ka bërë studime të thella disa qindra faqes, ku deklarojnë se në bazë të grupeve, njerëzit që kanë përdorur këto produkte kanë shanse më të larta për të lënë duhanin.

Sot nuk jemi në komision për të debatuar nëse cigarja është e dëmshme apo jo, por për të parë një mënyrë të re të trajtimit të teknologjive të reja, të investimeve të reja në këtë fushë. Mendoj se edhe Shqipëria, si shumë shtete europiane, duhet t'i marrë parasysh, t'i trajtojë dhe të hedhë sytë në rajon dhe në Europë, ku për këto produkte po krijohet mundësia që të monitorohen. Kjo çështje shumë interesante u diskutua në *Konferenc of Partis 8*, ku u tha se duhet të monitorohen, të studiohen dhe në KOP 9 të diskutohen rezultatet e këtyre monitorimeve. Këto janë komentet e mia të përgjithshme dhe jam i hapur për çdo pyetje.

Faleminderit!

Enver Roshi – Zoti Lorent, ju i keni sjellë propozimet tuaja?

Jam dakord që industria duhet të përsosë teknologjinë e prodhimit, por pa harruar që duhani, sido që të jetë, me industri, pa industri, është i dëmshëm për shëndetin e njeriut në të gjitha aspektet

Kalojmë te zoti Përparim Tushaj, konsulent për industrinë e duhan-cigareve.

Përparim Tushaj – Faleminderit!

Nuk po ndaloj të falënderoj për bashkëpunimin që kemi pasur deri tani.

Ky është një nga për një nga ligjet që kemi bashkëpunuar më mirë për të arritur një qëllim të përbashkët. Edhe ne, si gjithë të tjerët, jemi prindër ose i përdorim produktet e tjera. Qëllimi është të mbrohet jeta e njerëzve. Ne punojmë për kompanitë, sikurse punojmë në punë të ndryshme, por jeta e çdo njeriu, mirëqenia e të gjithëve është kryesorja.

Unë nuk dua të ndalem në gjërat specifike që kemi diskutuar, por duke u nisur nga këto që u thanë deri tani, e para dhe më kryesorja për industrinë e duhanit është rregulli, zbatimi i ligjit dhe formalizimi i çdo pike ku kalojnë produktet e duhanit. E përmendi edhe kolegu im, rreth 40 e produkteve të duhanit shitet pa kaluar në asnjë lloj kontrolli. Produktet që importohen nga kompani dhe që kontrollohen nga Ministria e Shëndetësisë, laboratorit i Ministrisë së Bujqësisë, dogana, e të tjera, kanë në vetvete të dhënat teknike, skedat dhe çdo gjë tjetër që duhet, kurse 40-i tjetër është totalisht jashtë çdo lloji kontrolli.

Fatkeqësisht, nga informacionet që kam unë të paktën, një pjesë e mirë e këtyre produkteve përdoren në shkolla për të futur brenda edhe marionetë tjera, të cilat po krijojnë një problem tjetër më të madh. Duke qenë duhan i hapur dhe i pakontrolluar, ai po përdoret edhe në këto drejtime. Ne mendojmë që duhet të luftojmë të gjithë së bashku për të pasur një kontroll total të produkteve të duhanit, jo vetëm të këtyre që importohen nga kompanitë, por edhe të të gjithë totalit tjetër.

Deri tani kanë qenë totalisht të pakontrolluara (me të drejtë Ministria e Shëndetësisë e ka kapur problemin e nargjileve), por tashmë me këtë ligj ato kontrollohen njësoj si të gjitha produktet e tjera të duhanit.

Për 95% të gjërave kemi rënë dakord me të dyja ministritë që kemi bashkëpunuar, por janë 2-3 gjëra, të cilat mendoj se kanë vend për t'u parë.

E para, është pika 7 e nenit 1, pirja e duhanit. Ne mendojmë që ai definicion duhet të mbetet siç është në ligjin aktual.

Për ta specifikuar më mirë këtë, definimi i “pirja e duhanit”, është: “Ndezja, thithja dhe mbajtja në dorë e ndezur e çdo produkti duhani që digjet”, siç është në ligjin aktual.

Për t'u krijuar këtë mundësi, që e tha kolegu im më parë, atyre që duan të kalojnë nga duhani klasik në produktet e reja, kemi propozuar në pikën 4 një shtesë, e cila lejon që këto produkte të reja të përdoren në të gjitha ambientet, së paku derisa të ketë studime të mëtejshme, duke plotësuar disa kushte.

Së pari, duhet të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave se çfarë kushtesh duhet të plotësojnë ambientet.

Së dyti, të ketë një leje të veçantë nga Ministria e Shëndetësisë për ambiente të tilla.

Së treti, ata pronarë që duan ta lejojnë duhet ta shkruajnë diku që këtu lejohet të përdoren produktet e reja dhe të paguajnë një tarifë të caktuar me vendim të Këshillit të

Ministrave. Pra, ky proces të jetë totalisht nën kontrollin e Ministrisë së Shëndetësisë, por t'u japim edhe mundësinë që nga duhani klasik të kalojnë te këto lloje duhanesh.

Një gjë tjetër që ne kemi shtuar është që paragrafi i tretë duhet të hiqet. Ministria përgjegjëse për Shëndetësinë përcakton ... Neni 6, paragrafi i dytë, mendojmë që nuk është relevant, sepse faktikisht ndalohen të gjitha llojet e shijeve. Nuk ka shumë rëndësi për ne, mund të jetë, mund të mos jetë, por për ta bërë ligjin më të kuptueshëm, mendojmë që nuk është relevant. Nëse Ministria e Shëndetësisë mendon se është, le ta lërë, por për sa kohë që ne do t'i ndalojmë të gjitha llojet e shijeve, mendoj që ky paragraf nuk mund të qëndrojë.

Çështja e fundit që ne kemi është neni 7, që është specifikim i nenit 13, ku ndalohet çdolloj forme reklamimi e të tjera. Ky nen, edhe në formën që ka pasur më parë, edhe në këtë formë që është këtu, mendojmë se krijon hapësira për trajtime të dyfishta. Për mendimin tonë, nuk është gjë e mirë që një inspektor ta lexojë ndryshe dhe një tjetër ndryshe. Në formën që është, për mendimin tonë, nuk është specifik, që nëse ti bën këtë gjë, atëherë ndodh kjo gjë, ose ti nuk duhet të bësh këto gjëra. Ky është shumë i gjerë dhe lejon që inspektorë të ndryshëm ta interpretojnë në mënyra të ndryshme.

Ky shqetësim ka ardhur nga shoqatat e shitësve, të cilët janë ankuar shpeshherë, që inspektorë të ndryshëm kanë thënë gjëra të ndryshme (njëri ka thënë që kjo është e bardhë, kurse tjetri ka thënë që është e zezë e tjera), dhe kanë vënë gjoba.

Për ta specifikuar më mirë këtë ne kemi bërë një propozim që jua kemi dërguar edhe juve. Pra, po flasim për nenin 7, që specifikon nenin 13.

Propozimi ynë është ky: “Ndalohet promovimi dhe reklamimi indirekt i produkteve të duhanit nëpërmjet logove dhe markave të regjistruara të produkteve të duhanit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse është kjo, janë në rregull.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Produktet e duhanit mund të paraqiten nëpër pikat e shitjes vetëm në paketimin e tyre origjinal. Ne kemi marrë eksperiencat më të mira dhe kjo është marrë pak a shumë nga ligji maqedonas. Çfarë arrihet nëpërmjet kësaj? Arrihet që unë si inspektor, kur të shkoj në një pikë shitjeje, nëse do të shikoj që është logo, do të marrë masa që të hiqet nga dyqani ose do të vë gjobë. Nëse është pjesë e markës së regjistruar (të gjitha markat tona zyrtare janë të regjistruara) dhe nëse ka një pikë, duke përfshirë edhe ngjyrat, atëherë përsëri është shkelje e ligjit.

Për sa i përket vendosjes së paketave të duhanit është specifikuar që lejohen vetëm paketa që janë zyrtarisht të njohura për t'u shitur dhe asnjëlloj gjëje tjetër. Mendojmë që në këtë mënyrë inspektorët e kanë më të thjeshtë dhe është më e drejtpërdrejtë, ashtu sikurse edhe shitësit e kanë më të drejtpërdrejtë që ta dinë që këto gjëra nuk lejohen.

Këto janë pak a shumë propozimet tona.

Ju falënderoj për kohën dhe vëmendjen!

Enver Roshi - Në cilësinë e kryetarit të komisionit, përpara se t'ia kalojë fjalën përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë, dua t'ju bëj një pyetje. Ju si industri a bëni analiza kimike të produkteve të duhanit që nxirrni në shitje? A keni laborator?

Së dyti, a e keni regjistruar industrinë e prodhimit të duhanit në rrjetin e gjithë prodhuesve të duhanit?

Përparim Tushaj - Për sa i përket pyetjes së parë, në bazë të ligjit të duhanit, të vitit 2006, deri në muajin mars të çdo viti dërgojmë në Ministrinë e Shëndetësisë të gjitha analizat që ju po përmendi, analizat kimike, e të tjera. Çdo kompani që është e regjistruar zyrtarisht në Shqipëri ka detyrimin ligjor që t'i dorëzojë në Ministrinë e Shëndetësisë. Unë i kam dorëzuar dorazi disa herë në Ministrinë e Shëndetësisë. Pra, është detyrim ligjor. Nuk flasë për ata që janë joligjorë.

E dyta, përveç kësaj, laboratori i Ministrisë së Bujqësisë bën analiza përpara se të japë të drejtën për çdo lloj pakete që të importohet apo të hidhet në tregun shqiptar. Pasi bëjnë rreth 15 analiza, ata japin një certifikatë, e cila i dërgohet doganës që të lejojë importin. Pa këtë certifikatë që merret në laborator nuk mund të bëhet importi apo hedhja në treg, nëse ka produkte vendi. Pra, në këtë aspekt janë të dyja të regjistruara. Ne nuk kemi një shoqatë të prodhuesve apo importuesve të duhanit, por të gjithë janë të regjistruar te laboratori i Ministrisë së Bujqësisë dhe te dogana, sepse është ligji i akcizave, i cili të detyron të regjistrohesh si importues apo si prodhues i të gjitha produkteve të duhanit.

Enver Roshi – Për interes të të gjithëve, laboratori i Ministrisë së Bujqësisë a është i certifikuar nga standardet e vendit dhe ato të komunitetit europian?

Përparim Tushaj – Ne kemi menduar që ky amendament që po bëhet të jetë më i gjerë dhe të punohet me një ligj tjetër. Ne me Ministrinë e Bujqësisë dhe me Ministrinë e Financave jemi duke punuar për një ligj më të gjerë që të rregullojë të gjithë spektrin, duke filluar nga fara

dhe deri te shitja në treg. Unë besoj se ky draftligj do të vijë në vjeshtë nga ministria përkatëse edhe te ju.

Për t'iu përgjigjur pyetjes së drejtpërdrejtë, laboratorit aktualisht nuk është i certifikuar nga Bashkimi Europian apo nga një organ tjetër që certifikon. Por në draftligjin e përgatitur nga Ministria e Bujqësisë është vënë si detyrë që për dy vjet laboratorit të certifikohet.

Kjo industri kalon jashtë kompetencave tona, por çdo analizë që vjen nga kompanitë tona është e certifikuar nga laboratorë të certifikuar nga Bashkimi Europian.

Për shembull, mund të flas për “Japan Tobacco”, i cili ka laboratorin në Trier të Gjermanisë, ndoshta specialistët e OBSH-es mund ta dinë, i cili është i certifikuar nga Bashkimi Europian. Pra, çdo analizë që dorëzojmë në Ministrinë e Shëndetësisë vjen nga laboratorët e certifikuar nga Bashkimi Europian.

Majlinda Halilja – A bëhen publike të dhënat që vijnë?

Përparim Tushaj – Ligjet e kanë përcaktuar se çfarë të dhënash duhet të bëhen publike dhe çfarë mbahen nga Ministria e Shëndetësisë, sepse vetëm për një produkt mund të jenë 50 deri në 100 faqe, ku përfshihen të gjitha gjërat se si prodhohet një produkt.

Ministria e Shëndetësisë i shikon dhe vendos për ato gjëra që duhet bërë publike, pra është në diskrecionin e Ministrisë së Shëndetësisë. Ne bëjmë publike atë që kërkon ligji dhe çdo gjë që duhet bërë publike është e shkruar në paketat e cigareve.

Enver Roshi – Zonja Rakacolli, çfarë mendimi keni në lidhje me sugjerimet që tha zotëria?

Mira Rakacolli – Siç u nënvizua edhe nga përfaqësuesit e grupeve të interesit këtu, procesi i diskutimit të ndryshimeve për ligjin e duhanit ka qenë një proces i hapur, transparent dhe ka ndjekur tavolina të përsëritura e debate në lidhje me problemet që u shfaqen edhe këtu.

Një debat i gjerë që u bë publik është edhe problemi i cigareve elektronike ose cigareve pa djegie. Vlerësimi i Ministrisë së Shëndetësisë për cigaret me ngrohje ose elektronike është se janë po aq të dëmshme për shëndetin sa cigaret e zakonshme. Këtë vlerësim e kemi të mbështetur në studime të vlerësuara mirë. Këtu kam një studim të diskutuar edhe me grupet e interesit, të cilin e kam sjellë edhe për anëtarët e komisionit, ky është studim i Shoqatës Europiane të Çrregullimeve Respiratore në lidhje me dëmet që shkakton kjo cigare në mushkëri.

Të mos harrojmë se edhe nga eksperiencia që kemi me vënien e filtrave në cigare ose propagandimi për përdorimin e cigareve të lehta, që quhen *light cigarettes*, nuk e ka ulur nivelin e duhanpirjes, pra kanë qenë trike që nuk e kanë dhënë rezultat. Gjithashtu, duke thënë se cigarja

elektronike nuk të dëmton aq shumë, mundet të nxisë pirjen e duhanit. Pra, ata që nuk pinë duhan, duke menduar që nuk e dëmtojnë shëndetin, mundet të fillojnë të pinë duhan me cigare elektronike, duke menduar që po bëjnë një zgjedhje të shëndetshme.

Cigaret e zakonshme që janë me djegie vërtet shkaktojnë një dëm të madh nga djegia, por kancerogjeniteti ose çrregullimet në koagulitetin e gjakut nuk lidhen me substancat që çlirohen gjatë djegies, përkundrazi lidhen më tepër me substanca që janë brenda në cigare.

Sot ka studime biologjike, të cilat tregojnë se cigaret elektronike krijojnë probleme në shtresat e qelizave të mushkërive dhe bronkeve. Deri më sot nuk ka asnjë provë që kalimi nga pirja e cigares së zakonshme në pirjen e cigares elektronike të ketë përmirësuar funksionin respirator.

Më pëlqeu shprehja që përmendi zoti Gonzalez: “Djalli është i fshehur në detaje”. Pra, cigarja elektronike nuk është e padëmshme ose më pak e dëmshme, sepse ajo krijon probleme në koagulitetin e gjakut. Varësia është nga nikotina dhe cigarja elektronike nuk e eliminon nikotinën, pra varësia vazhdon.

Ekipi i Ministrisë së Shëndetësisë, duke u mbështetur edhe në konsulencat me mjekë ekspert të fushës, është i mendimit se masat për këtë cigare duhet të jenë njësoj me cigaret e tjera. Thënia nga institucionet shëndetësore që kjo cigare është më pak e dëmshme u shërben reklamave për këto cigare. Qëndrimi i Ministrisë së Shëndetësisë për këto cigare është i prerë dhe i bazuar në evidencat europiane.

Faleminderit!

Enver Roshi – Po, zoti Gonzalez.

Raul Gonzalez – Ju falënderoj për saktësimin që bëtë për këtë cigare! Në fakt, edhe Konventa për Kontrollin e Duhanit specifikon në mënyrë të qartë se nuk duhet të ketë një trajtim të ndryshëm ndërmjet cigares elektronike dhe cigares me ndezje, por të jenë pjesë e të njëjtit ligj.

Duhet të kemi parasysh që, nëse bëjmë një krahasim me hedhjen në treg të një medikamenti të ri, kompania që e ka shpikur, duhet të paraqesë një numër shumë të lartë të studimeve, të cilat nuk paraqesin vetëm benefitet dhe përmirësimin që bën, por edhe efektet negative. Pra, ideja është se nuk mund të jemi kaq tolerantë me cigaren elektronike.

Nga ana tjetër, Ministria e Shëndetësisë dhe ky komision duhet të ketë parasysh që nuk duhet punuar vetëm në mbrojtjen e njerëzve nga sëmundjet, por edhe në promovimin e një jete të shëndetshme.

Hedhja në treg e një produkti që ka nikotinë është e sigurt që tek konsumuesit krijon varësi dhe, duke pasur parasysh efektet e këqija, shkakton edhe dëme.

Për sa u takon cigareve të paligjshme, ky fenomen duhet parë më gjerë. Pra, a ka cigare të paligjshme që futen në Shqipëri? Po, ka. A ka armë që futen në mënyrë të paligjshme? Po, ka. A ka opium që futet në mënyrë të paligjshme? Po, ka. Mënyra për t'i luftuar këto fenomene nuk është legalizimi i tyre, por ndalimi i tyre në të gjitha llojet e mënyrave.

Për sa u takon logove, ju duhet të ndiqni shembujt e vendeve më të avancuara të Bashkimit Europian, pra duhet të jeni të avancuar në këtë drejtim. Duhet të ndalohen ngjyrat e ndryshme të logove dhe të jetë një logo e thjeshtë për të gjitha këto produkte, në mënyrë që të mos ketë diferencim ndërmjet kompanive të ndryshme, pra të jetë një paketim neutral.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit, zoti Gonzales!

Po, zoti Gordi.

Lorent Gordi – Për t'u rikthyer te kërkimet, unë bëra një panoramë të përgjithshme që në fillim. Sot ka studime që tregojnë uljen e toksicitetit nga cigaret elektronike, si për shembull, ka një studim të Komitetit për Shkencë dhe Teknologji i “House of Commons” në Angli, i cili e shpreh qartë këtë gjë. Ka një *evidence review of e-cigarettes and heated tobacco products* të vitit 2018, një artikull i publikuar nga shëndeti publik i Anglisë, të cilët kanë një plan të mirëmunduar se si do ta heqin cigaren me djegie njëherë e përgjithmonë nga qarkullimi, duke pranuar një produkt me më pak dëme.

Dua ta falënderoj zonjën Rakacolli, e cila theksoi se ne nuk themi kurrë që kjo është më e shëndetshme se ajo apo e kundërta, por ne themi se këto produkte kanë një rrezikshmëri të ulur për atë që e pi duhanin.

E fundit, unë përfaqësoj kompaninë “Filip Morris Intenacional”, Amerika mori dy vjet kohë për të parë 6700 faqe kërkime të kompanisë sonë, vetëm për të lejuar shitjen e këtyre produkteve në të gjitha shtetet amerikane. Këto produkte janë pranuar si të përshtatshme për shëndetin publik nga “Food and Drug Administration”, një institucion shumë prestigjioz, si në pranimin e këtyre produkteve, ashtu dhe të produkteve të mjekësisë e të tjera.

Ne nuk po flasim për Ministrinë e Shëndetësisë apo inspektoratet përkatëse që luftojnë tregtinë e paligjshme në kufi, por po flasim për shëndetin publik, i cili përbëhet nga ata që e pinë duhanin dhe ata që nuk e pinë.

Po e përsëris edhe një herë pyetjen: a duhet që ne t'i kemi parasysh duhanpirësit? A duhet të ulim me 95%, me 30 apo me 20%, pra me sa mundësi që kemi sasinë e drogërave që marrin ata që janë të varur nga droga? Trajtimi zyrtar i tyre në spitalet tona është me metadon. Po, çfarë është metadoni? A është edhe kjo një drogë? A ka edhe kjo pasoja negative? Ka, por pasojat janë më të vogla se përdorimi i drogërave më të rënda.

Faleminderit!

Enver Roshi – Gjithnjë ne i referohemi Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Kur vjen puna për hartim ligjesh, për të marrë një mendim profesionist, Organizata Botërore e Shëndetësisë është udhëzuesja e udhërrëfyesja e hartimit të ligjit kundër duhanit.

Duke ju falënderuar për sugjerimet tuaja në ato që sollët, për platformën tonë profesionale ne i referohemi Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Pra, ajo mbetet për ne busulla orientuese e ligjbërjes.

Faleminderit!

Fjalën e kërkoi Klodi. Më pas Edlira. Mondi i tretë.

Edlira Bode – Faleminderit!

Shumë shkurt. Kam vetëm një pyetje. Edhe zoti Gordi, edhe zoti Tushaj përmendën një shifër, e cila në gjykimin tim është alarmante. Ju thatë se 40 % e tregtisë së produkteve të duhanit në Shqipëri, bëhet në kundërshtim me ligjin.

E para, doja të dija se ku mbështetet kjo shifër? Kush e ka matur, kush e ka nxjerrë, sa është reale dhe sa është e konfirmuar?

E dyta, doja të dija nëse nga Ministria e Shëndetësisë ka ndonjë strategji në lidhje me reduktimin e kësaj shifre. Ky ligj që ne po miratojmë, a i ka masat e duhura që ne të shkojmë drejt uljes së tregtimit të paligjshëm, deri në ndalimin e tij? Për sa kohë mendohet se mund ta realizojmë këtë në Shqipëri?

Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Fatmir Kazazi – ...përfaqësues i industrisë dhe i...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, Fatmir Kazazi quhem.

Enver Roshi – Po, sepse e kishim në plan për t'ju dëgjuar.

Fatmir Kazazi – Mendoj se të dyja pyetjet janë shumë të sakta, qëndrojnë. Unë desha ta nis, njëlloj si zoti Gonzalez, se cili është problemi dhe cili duhet të jetë prioriteti. Ka shumë shtete që i kanë përqaftuar dhe nënshkruar konventat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, por jo tek të gjitha është i njëjti nivel i zbatimit të ligjit.

Pyetja ime shtesë do të ishte: a duhet që Shqipëria të jetë në ballë, pra e para në detaje, në ligj, por e fundit në zbatim? Kjo është pyetje shumë e thjeshtë. Sepse ne gjithmonë duam të bëhemi të parët për të shkruar një rregull, por të fundit për ta zbatuar atë.

Për sa i përket pyetjes, desha të them si parantezë, se shteti është aksioneri kryesor në këtë industri. Pra, në çdo paketë cigaresh që shitet formalisht, e cila kushton 2, 5 euro – 3 euro në Shqipëri, kompanive prodhuese u shkojnë 0, 5.

2 deri në 2, 5 euro i merr shteti në formën e taksave. Kjo është shumë e drejtë dhe një nga masat më efikase, e cila do ta reduktojë konsumin e do t'i japë shtetit mundësinë ta bindë popullatën që ta adresojë këtë problem.

Të gjithë biem dakord se duhani është i dëmshëm, por a është më pak i dëmshëm ai që shitet në mënyrë të paligjshme, që shitet me çmime 5 deri në 6 herë më të lira, që shitet haptas në çdo treg të Shqipërisë: duhani i hapur dhe duhani i prodhuar në mënyrë artizanale? Ato shiten nëpër kuti, me tuba, plus makinerinë që i mbush shumë lehtë, dhe shiten me një çmim pesë herë më të lirë.

Cila është mbështetja për shifrën 40 %, që unë them se është akoma më e lartë? Ne kemi bërë studime në disa forma: kemi marrë publikimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë në lidhje me numrin e duhanpirësve, kemi bërë shumëzime, dhe na ka dalë se në Shqipëri konsumohen rreth 5000 tonë duhan, ndërkohë që në Ministrinë e Financave raportohen 3000 tonë.

Për ta bërë më të lehtë, po jap një shembull tjetër. Marrim Maqedoninë, të cilën e kemi shumë pranë dhe me kushte shumë të ngjashme: ajo raporton 4500 tonë konsum cigaresh në vit. Maqedonia ka një popullsi prej 2 milionë banorësh. Shqipëria ka 2, 8 milionë – 3 milionë banorë, por raporton 3000 tonë.

A ka ndonjë këtu që mund ta besojë se në Shqipëri pihet duhan sa gjysma e duhanit që pihet në Maqedoni? Është i njëjti mentalitet, i njëjti rajon, e njëjta traditë e duhanit. Unë s'do të doja t'ju humbisja kohën, por nga kjo tregti e paligjshme prej 40 % – 50 %, shteti humbet mbi 100 milionë euro.

Unë jam dakord që duhani është i dëmshëm, por prioriteti i Shqipërisë është pikërisht ky: çfarë bën ligji, çfarë bëjmë ne, për të mos lejuar që në çdo treg të shitet haptas një cigare me çmim pesëfish më të lirë, sepse në këtë mënyrë i devijojmë konsumatorët drejt një tregu të paligjshëm, gjë të cilën po e bëjmë duke forcuar masat ndaj prodhuesve dhe shitësve të ligjshëm.

Unë përfaqësoj rreth 15 mijë shitës me pakicë, të cilët ankohen vetëm për këtë problem: që tek dera e dyqanit shitet haptas duhani i hapur, i pakontrolluar. Kjo është.

Faleminderit!

(Ndërprerje e shkurtër incizimi)

Vjollca Braho – Faleminderit!

Jam Vjollca Braho, Kryeinspektorja e Shqipërisë për Shëndetësinë. Në vijim të asaj që tha zoti Fatmir Kazazi, që Shqipëria është e para për sa i përket hartimit të një legjislacioni kaq të mirë në lidhje me luftën ndaj duhanpirjes, por jemi të fundit në lidhje me zbatimin, dua t'ju them se pak më parë të gjithë ne jemi njohur në lidhje me rezultatet që dha Komisioni Europian, sipas të cilave, në Shqipëri zbatimi i ligjit për duhanpirjen është realizuar në mënyrë të plotë. Mund të them se vetëm në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019 janë kryer 1591 inspektime dhe janë marrë 296 masa administrative. Përveç punës mjaft të mirë që bëhet nga drejtoritë rajonale, kemi ngritur edhe task forcen për luftën kundër duhanit, si dhe për të gjitha ligjet e tjera që zbaton Inspektoriat Shtetëror Shëndetësor. Janë vendosur 115 masa vetëm nga task forca. Pra, vetëm në gjashtëmujorin e parë, ne kishim 296 masa administrative, duke e krahasuar me gjashtëmujorin e vitit 2018, që ishin 143 masa administrative.

Pra, dua të kundërshtoj atë që u tha pak më parë, si dhe të shprehem për punën e mirë që është bërë nga Inspektoriat Shtetëror Shëndetësor dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin me korrektësi të ligjit të duhanpirjes.

Gjithashtu, pak më parë, nga zoti Philip Morris dhe nga zoti Përparim u dha një mendim në lidhje me ndryshimet ligjore që duhen bërë sa i takon duhanpirjes në mënyrë elektronike ose pa djegie, pra për ta lejuar në ambientet e brendshme, kundrejt një pagese, një takse, apo për të pirë në ambiente të posaçme. Unë mendoj se ne nuk duhet ta bëjmë, pasi kjo është një formë reklame që i bëjmë këtij lloj duhani, i cili është pa djegie dhe në mënyrë elektronike. Kjo do t'i trajtonte subjektet në mënyrë jo të barabartë. Pavarësisht studimeve që janë bërë, sipas të cilave pirja në mënyrë elektronike mund të jetë më pak e dëmshme, ajo sigurisht që përmban nikotinë. Kështu, të gjithë peronat e tjerë, që janë duke pirë kafe apo janë me fëmijë të vegjël, nuk kanë pse të marrin

nikotinën e atij personit, i cili dëshiron të pijë një cigare elektronike ose një cigare pa djegie. Kësisoj, të gjithë subjektet duhet të jenë të barabartë, si në rastin e cigares me djegie, ashtu edhe në rastin e cigares pa djegie.

Faleminderit!

Klodiana Spahiu – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, do të doja ta nisja fjalën time me një falënderim të veçantë ndaj të dyja palët e përfaqësuesve që kemi sot në këtë seancë dëgjimore: për zotin Gonzalez, sepse Organizata Botërore e Shëndetësisë ka qenë gjithmonë mbështetje për komisionin tonë, sidomos sa i takon këtij projektligji. Falënderime edhe për të gjithë përfaqësuesit që kanë ardhur sot në komision, duke sjellë edhe materialet e tyre, përfaqësues të ligjshëm, do të thosha, sepse siç u ngrit shqetësimi edhe nga parafolësit, me sa po kuptoj, këtu ka një problem shumë të madh në lidhje me çështjen e tregtisë së paligjshme, që realisht i shqetëson.

Unë do të thosha se ky komision nuk e vë fare në dyshim shqetësimin që ngrihet, që cigare elektronike është e dëmshme, sepse ne jemi në përpjekje të vazhdueshme për ta përmirësuar jetën e qytetarëve. Po të jemi në këtë pikëpamje, ne ndjehemi të vendosur të mbrojmë çdo qytetar nga dëmi që i shkakton qoftë edhe cigarja elektronike, edhe nëse supozojmë se është më pak e dëmshme.

Organizata Botërore e Shëndetësisë thotë se nuk ka studime të mirëfillta, që kjo cigare nuk është e dëmshme, ashtu siç mund të ketë studime për medikamentet, kur hidhen në treg. Megjithatë, unë them se ne do të marrim vendimet tona në miratimin nën për nen, duke pasur në fokus qytetarin, domethënë mbrojtjen e shëndetit të qytetarit.

Unë kam dy shqetësime: i pari është lidhet me ankesat që ju keni bërë, me monitorimin dhe mënyrën e rregullimit të pjesës informale, që mendoj se nuk i takon këtij komisioni. Një prej kolegëve tuaj diskutoi për një projektligj të ri, i cili tashmë po hartohet, i cili ka lidhje me prodhimin dhe përpunimin e duhanit. Besoj se ai do të jetë ligji, i cili do të rregullojë edhe këtë pjesë informale në sektorin tuaj.

Shqetësimi i dytë që kam, bazuar edhe në ankesat tuaja, është “abuzimi” që ndodh shpeshherë me pseudoambientet që mund të jenë gjysmë të hapura, të cilave, edhe me mbështetjen e kolegëve të komisionit, duhet t’u japim një drejtim. Është e vërtetë se në praktikën e përditshme kemi hasur ankesa pafund nga ana e subjekteve të restoranteve e bareve, që ka selektivitet lidhur

me faktin se diku vihet gjobë, diku nuk vihet gjobë, si dhe me mënyrën se si trajtohet një ambient, i cili nuk është tërësisht i mbyllur, por që mund të jetë me plastikë.

Kështu, ne duhet të jemi të vendosur për t'i dhënë një drejtim e një përgjigje edhe këtij shqetësimi të të gjitha subjekteve që kanë sjellë ankesat e tyre. Besoj se me mbështetjen e anëtarëve të komisionit, atyre të opozitës e të maxhorancës, ne e vlerësojmë punën tuaj dhe të gjithë këtij biznesi, që është marrë kaq shumë vite me këtë sektor të tregtisë. Ne besojmë se kjo cigare, kjo formë e re e cigares elektronike, e cigares me ngrohje apo cigaret e të gjitha formave të reja mund të jenë më pak të dëmshme, por pa u vërtetuar shkencërisht një gjë e tillë, askush prej nesh nuk ka të drejtë të vihet në mbështetje të promovimit të këtij promovimi.

Unë i dëgjova të gjithë parafolësit, dhe mendoj se në pozicionin e mjekut, disa prej atyre teorive nuk qëndrojnë. Është e vërtetë se ne kemi një përdorues, metadonin, që e përdorim kur duam të heqim varësinë nga droga, por mendoj se nuk ka asnjë lloj ngjashmërie me rastin e cigares elektronike sepse, në të vërtetë, cigarja elektronike e ka nikotinën brenda dhe nuk besoj se e heq varësinë nga duhani. Pasi të vërtetohet... Qofshim ne gabim, por besoj se nuk jemi gabim në këtë pikë. Ne të gjithë, edhe ju së bashku me ne, jemi për një qëllim: të dëmtojmë sa më pak. Këto shifra kaq të larta e alarmante në lidhje me përdoruesit e duhanit në vendin tonë tregojnë se ne duhet të punojmë më fort në çdo institucion, për të ulur konsumin e duhanit, për të ulur shkallën e informalitetit në qarkullimin e duhanit në vendin tonë, si dhe për të bërë ç'është e mundur që të promovojmë një jetë e shëndetshme.

Në fakt, unë kisha vetëm një pyetje për profesor Gonzalezin, bazuar edhe në realitetin shqiptar. Neve na kanë ardhur disa propozime edhe nga grupet e interesit. Bazuar në fjalën tuaj, duke vlerësuar punën dhe studimet e deritanishme, padyshim që jemi të vendosur kundër promovimit të përdorimit të cigares elektronike, të cilën duhet ta trajtojmë njëlloj si duhanin me ndezje.

Ne realitetin shqiptar ndodh të ketë abuzime në këtë pikë, lidhur me përdorimin e duhanit në ambientet e mbyllura. Kemi disa variante nga vende të ndryshme, në të cilat ka hapësira të kufizuara. Nuk e kam fjalën për duhanin me ndezje, por vetëm për cigaren elektronike. A mendoni ju se në një sipërfaqe më pak se gjysma, përdorimi i cigares elektronike, gjithmonë me shenjën e lejimit, do të ishte një mënyrë zgjidhjeje, në një farë mase bazuar edhe në kërkesat që vijnë nga bizneset, restorantet, baret në Shqipëri?

Raul Gonzalez – Rekomandimi i Organizatës Botërore të Shëndetit është shumë i qartë sa i takon cigares elektronike, pavarësisht shembujve të ndryshëm që mund të vijnë nga vende të ndryshme. Rekomandimi është i qartë: trajtojeni cigaren elektronike në të njëjtën mënyrë sikundër trajtoni edhe cigaren klasike. Kjo do të thotë se, edhe për rastet e hapësirave të mbyllura, në qoftë se duhet të zgjedhim mes interesave të operatorëve, që vijnë e shprehin këto problematika e këto kërkesa, dhe interesit në lidhje me të shëndetit të qytetarit, Organizata Botërore e Shëndetësisë është shumë e drejtpërdrejt dhe shumë e qartë: është interesi i shëndetit të qytetarit, ai që duhet të prevalojë.

Enver Roshi – Faleminderit!

Doktor Mondit, kishit gjë për të thënë?

Edmond Stojku - Në fakt, bëhet fjalë për këtë 40%-in që kalon pa kontroll, pra që është i paligjshëm. Atëherë, problemi më i madh i këtyre produkteve, që kalojnë pa kontroll, është se ato nuk kanë cilësinë e duhur, që është shumë e rëndësishme, apo janë thjesht konkurrentë të padenjë në treg? Si është arritur ky konkluzion? A është bërë ndonjë analizë statistikore? A është bërë ndonjë projekt, apo ndonjë studim informues? A ka ndonjë informacion se nga kanë dalë këto të dhëna?

(Diskutime pa mikrofon.)

Problemi është që ne thjesht duhet të marrim vesh se nga e dini ju këtë fakt? Kjo për ne është shumë e rëndësishme për arsye bashkëpunimi.

Përparim Tushaj – Për t'iu përgjigjur pyetjes, do të thosha se unë kam qenë pjesë e një projekti prej 3 vjetësh, dhe kemi bërë anketime në çdo pjesë të territorit të Shqipërisë, por edhe të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi. Ne kemi marrë informacione zyrtare, por kemi bërë edhe anketime direkte. Konsumi i cigares, ashtu si shumë produkte të tjera, nuk mund të bjerë ose të rritet në mënyrë drastike. Kjo është e provuar në qindra vjet histori dhe ne kemi statistika shumë të sakta. Për shembull, në postkomunizëm Shqipëria konsumonte 6 mijë tonë cigare. Ne kemi statistika të viteve të mëvonshme, ku taksat nuk kanë qenë shumë të larta, por, për hir të së vërtetës, konsumoheshin 4000 apo 4500 tonë cigare. Me rritjen e akcizës kjo tendencë vërehet në të gjithë botën, sepse mendohej se rritja e taksave do të ulte edhe konsumin e cigareve, por kjo ndodh vetëm në një treg të kontrolluar mirë. Pra, kjo është e provuar në Zvicër apo në vende të tjera të Europës, por në Shqipëri nuk u ul konsumi ose u ul shumë pak, por tregu devijoi drejt prodhimit të paligjshëm, i cili u bë shumë atraktiv, sepse për një paketë, që kushton 3 mijë lekë të vjetër, kostoja

kurrë nuk i kalon 500 lekë të vjetër, madje ky është çmimi në tregun e zi, sepse 300 apo 400 lekë të vjetër është kostoja. Kështu që, kur ne themi 40 apo 45%, duhet të kemi parasysh se janë prodhues të paligjshëm dhe kontrabandistë, të cilët i marrin cigaret...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Janë kryesisht të brendshëm dhe të jashtëm. Kjo gjë është e provuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Shumica janë të brendshëm. Është prodhim artizanal, por jo dhe aq artizanal, që është i theksuar më shumë në zonën e Shkodrës. Në pjesën Veriore të Shqipërisë ka shumë fshatra, që kanë industri vetëm për prodhimin e duhanit. Këto vende mund të vizitohen lehtë dhe ata që, punojnë në këto vende e shprehin hapur këtë gjë, madje janë të gatshëm që t'i tregojnë edhe makineritë ku e prodhojnë dhe si e shpërndajnë duhanin. Mund të them se duhani ynë shkon deri në Poloni dhe në Rusi nëpërmjet Malit të Zi. Pra, shifrat nuk mund të ndryshojnë. Unë mora si shembull Maqedoninë, e cila e kontrollon shumë më mirë këtë treg, sepse prodhon rreth 20 mijë tonë cigare dhe është eksportuese kryesore, siç edhe ne kemi qenë më parë, sepse rajoni e ka traditë prodhimin e duhanit, por askush nuk e beson se Maqedonia me 2 milionë e gjysmë banorë konsumon 4500 tonë duhan, kurse vendi ynë me gati 3 milionë banorë konsumon 3000 tonë, sepse kaq është konsumi zyrtar me taksa të paguara, pa llogaritur pastaj turistët që vijnë. Ka me qindra faqe studime, mbi bazën e anketimeve që kemi bërë, dhe kemi parë se sa shiten këto tubat bosh, sa shitet letra e duhanit, sa prodhojnë fermerët, duke investuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, ne këtë gjë po mundohemi të bëjmë me ligjin e duhanit, por ky është prioriteti i Shqipërisë. Unë jam shumë dakord që cigarja elektronike është e dëmshme, por a duhet të bëjmë ne diferencime? Edhe alkooli është i dëmshëm, por a është njëlloj me birrën, me verën apo me rakinë ose me alkoolin, që prodhohet në mënyrë joligjore me substanca të dëmshme? Ne këtë po themi: si duhet ta zgjidhim këtë problem për Shqipërinë, në mënyrë që të përmirësojmë shëndetin...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, por nuk mund ta bëjmë ne të parët një marrëveshje kuadër, sepse në Gjermani shiten kudo cigaret elektronike, madje u bëjnë edhe reklamë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Edmond Stojku – Ju rekomandoj që të qëndrojmë tek tema. Unë në atë kohë kam qenë drejtor i Përgjithshëm në ministri dhe diskutimi ka qenë që Gjermania, Italia dhe Franca nuk e

njihnin ligjin, kurse ne e kishim miratuar dhe e kishim vënë në zbatim. Ndoshta ne diku jemi të parët dhe diku tjetër jemi të fundit, por, realisht, unë do të doja bashkëpunimin me ju si biznes për të arritur më të mirën e mundshme si për shëndetin e qytetarëve, por edhe për buxhetin. Pra, nëse ne do të kishim dëshirën e mirë, do të arrinim të realizonim interesat e të dyja palëve, por patjetër parësore mbetet shëndeti i popullatës.

Faleminderit!

(Diskutime pa mikrofon.)

Përparim Tushaj – Unë nuk mendoj se rezultati është arritur 100%. Nëse do të masim tregun e duhanpirësve apo nëse shkojmë në lokalet e natës, do të vëmë re se duhani pihet 100%. Atëherë, është më mirë që të krijojmë një ambient të veçantë, në mënyrë që të mos i trajtojmë si armiq duhanpirësit. Pra, kjo është çështja që ne shtrojmë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Florenc Spaho – Faleminderit, zoti kryetar!

Meqenëse të gjithë jemi këtu për një qëllim, për shëndetin sa më të mirë të popullatës, atëherë pse duhet ta diferencojmë duhanpirjen elektronike nga duhanpirja me ndezje, duke qenë se e keqja mund të ndalohet që në origjinë? Pra, pse duhet që ne t'i diferencojmë të dyja këto mënyra të pirjes së duhanit (zoti Lorenc tha se kemi ulur 95% toksicitetin, që ndoshta nuk është e vërtetuar shkencërisht nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, por, gjithsesi, e marrim të mirë qenë), kur të keqen mund ta ndalojmë që në origjinë dhe t'i trajtojmë të dyja njëllor? Ku është problemi që duhet ta diferencojmë duhanpirjen elektronike nga ajo me ndezje, duke hequr pjesën financiare? Ndoshta përfaqësuesi i ministrisë pretendon se kjo gjë do të ulë ndjeshëm anën financiare të kompanisë dhe do të ketë reagim nga popullata që pi duhan. Ne duhet të mundohemi që t'i fenojmë njerëzit të pinë duhan, qoftë edhe ata që pinë cigare elektronike. Në ditët e sotme po bëhet trend edhe për ata njerëz, që nuk e kanë pirë më parë cigaren, të cilët mendojnë se, duke e pirë këtë cigare elektronike, do ta dëmtojnë më pak veten.

Faleminderit!

Almira Xhembulla – Kam diçka për procedurë, duke qenë se i dhamë një fokus të gjerë informalitetit...

Enver Roshi – Përqendrohuni te ligji.

Almira Xhembulla – Do të përqendrohem te ligji, meqenëse është për mbrojtjen e shëndetit nga duhani. Në qoftë se kemi ndonjë shqetësim lidhur me informalitetin apo diskutime

të tjera, mund të bëjmë një dëgjesë në një moment të dytë me kryeinspektoren, ndoshta edhe me grupet e interesit.

Enver Roshi – Ju falënderoj për argumentet e sjella në këtë tryezë! Natyrisht komisioni do të mbledhet sërish në javët e ardhshme për t'i analizuar nen për nen ndryshimet e këtij projektligji.

Mbledhja mbyllet këtu.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA